



Federata Aeronautike e Kosovës

# STATUTI

**I miratuar në mbledhjen e Kuvendit të FAK-ut**

**22 SHKURT 2020**

*Federata Aeronautike e Kosovës  
Rr. Agim Ramadani pn,  
10000, Pristinë  
Republika e Kosovës*

*[info@aeronautika.org](mailto:info@aeronautika.org)  
[www.aeronautika.org](http://www.aeronautika.org)*

# **Federata Aeronautike e Kosovës**

**Copyright © 2020.**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. E drejtat e autorit në këtë dokument është pronë e Federatës Aeronautike të Kosovës (FAK). Çdo person i cili vepron në emër të FAK-ut ose të ndonjërit prej Anëtarëve të tij, është i autorizuar që të kopjoj, shtypë, dhe shpërndajë këtë dokument, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- 1. Ky dokument mund të përdoret vetëm për informacion dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime komerciale.**
- 2. Çdo kopje e këtij dokumenti ose një pjese të tij duhet të përfshijë këtë njoftim për të drejtën e autorit.**

# Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Termet dhe përkufizimet .....	6
Regjistri i amendamentimit të Statutit të FAK-ut .....	7
Kapitulli 1 .....	8
<b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>8</b>
1.1 Misioni.....	8
1.2 Struktura organizative.....	8
1.3 Qëllimet dhe Objektivat e FAK.....	9
1.4 Funksionet dhe Përgjegjësitë e FAK.....	9
1.5 Statuti i FAK-ut .....	11
1.6 Rregulloret e FAK-ut.....	11
1.7 Logo dhe asetet tjera të përfaqësimit.....	11
1.8 Përfaqësimi i FAK-ut.....	12
1.9 Marrëdhëniet dhe asocimi me organizatat tjera .....	12
1.10 Parimet e menaxhimit të FAK-ut.....	12
1.11 Shpërbërja.....	13
Kapitulli 2 .....	14
<b>Anëtarësimi dhe Pjesëmarrja në FAK .....</b>	<b>14</b>
2.1 Klasat e Anëtarësisë së FAK .....	14
2.2 Aplikimi për Anëtarësim.....	15
2.3 Vlerësimi i aplikimit për Anëtarësim.....	15
2.4 Mbajtja e statusit të Anëtarit Aktiv.....	16
2.5 Anëtar Aktiv .....	17
2.6 Anëtar i Përkohshëm.....	17
2.7 Anëtar Joaktiv .....	18
2.8 Standardet detyruese për anëtarët .....	18
2.9 Tarifa vjetore e anëtarësisë .....	19
Kapitulli 3 .....	21
<b>Kuvendi .....</b>	<b>21</b>
3.1 Mbledhja e Kuvendit.....	21
3.2 Përbërja e Kuvendit.....	22
3.3 Kuorumi dhe vlefshmëria e kuvendit.....	23

3.4	Kompetencat e Kuvendit.....	23
3.5	Votimi në Kuvend.....	24
Kapitulli 4	.....	26
	<b>Bordi Ekzekutiv i FAK-ut</b> .....	<b>26</b>
4.1	Përbërja e Bordit Ekzekutiv.....	26
4.2	Zgjedhja e Bordit Ekzekutiv.....	26
4.3	Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv.....	28
4.4	Kompetencat dhe Detyrat e Bordit Ekzekutiv.....	28
4.5	Votimi në Bordin Ekzekutiv .....	29
Kapitulli 5	.....	31
	<b>Këshilli Mbikëqyrës</b> .....	<b>31</b>
5.1	Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës .....	31
5.2	Zgjedhjet e Këshillit Mbikëqyrës.....	31
5.3	Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës .....	32
5.4	Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës .....	32
5.5	Votimi në Këshillin Mbikëqyrës.....	32
Kapitulli 6	.....	33
	<b>Kryetari i FAK-ut</b> .....	<b>33</b>
6.1	Zgjedhja.....	33
6.2	Nominimi i Kryetarit.....	33
6.3	Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit.....	34
6.4	Kryetari i Nderit.....	35
Kapitulli 7	.....	36
	<b>Nënkryetari</b> .....	<b>36</b>
7.1	Roli dhe përgjegjësia .....	36
Kapitulli 8	.....	37
	<b>Sekretari i Përgjithshëm</b> .....	<b>37</b>
8.1	Detyrat dhe Përgjegjësitë .....	37
Kapitulli 9	.....	38
	<b>Financat e FAK-ut</b> .....	<b>38</b>
9.1	Llogaritë Financiare të FAK-ut dhe Auditimi .....	38
9.2	Raportimi Financiar në FAK.....	39
Kapitulli 10	.....	40
	<b>Akademia Aviacionit Artan Venhari</b> .....	<b>40</b>
10.1	Dispozitat e Përgjithshme .....	40

10.2	Detyrat e Drejtorit.....	40
Kapitulli 11	.....	42
	<b>Transparenca dhe Dispozitat Përfundimtare .....</b>	<b>42</b>
11.1	Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun .....	42
11.2	Dispozitat Përfundimtare.....	42

## Termet dhe përkufizimet

<b>FAK</b>	Federata Aeronautike e Kosovës
<b>FAI</b>	Fédération Aéronautique Internationale - Federata Aeronautike Ndërkombëtare
<b>AAC</b>	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
<b>KOK</b>	Komiteti Olimpik i Kosovës
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës

## Regjistri i amendamentimit të Statutit të FAK-ut

Amendamentimet dhe versionet e plota të amendamentuara të Statutit të FAK-ut janë të publikuara në faqen e internetit të FAK-ut kurdo që një amendamentim të miratohet nga Kuvendi i Përgjithshëm i FAK-ut. Statuti i ri i plotë do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të FAK-ut sapo të jetë i gatshëm, pas secilit amendamentim.

<b>Data e amendamentit</b>	<b>Përshkrimi i shkurtër i amendamentimit</b>	<b>Nënshkrimi i kryesuesit</b>
<b>Tetor 2014</b>	Amendamentimi i plotë i statutit	
<b>Prill 2018</b>	Riformatimi dhe amendamentimi i plotë i statutit	
<b>Shkurt 2020</b>	Amandamentimi i statutit 22 Shkurt 2020	

# Kapitulli 1

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

---

### 1.1 Misioni

- 1.1.1 Të gjithë të kenë mundësinë të fluturojnë dhe garojnë të barabartë dhe të sigurtë në çdo cep të vendit.

### 1.2 Struktura organizative

- 1.2.1 Federata Aeronautike e Kosovës (FAK) është Federata Kombëtare e Sporteve Ajrore të Republikës së Kosovës, që përbëhet nga organizatat kombëtare aeronautike dhe astronautike të cilat pajtohen me Statutin e FAK-ut .
- 1.2.2 FAK-u është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e cila përmbahet nga përfshirja në dallime racore, politike dhe fetare gjatë aktiviteteve të saj.
- 1.2.3 Kushtetuta e FAK-ut përbëhet nga Statuti dhe rregulloret e FAK-ut, të cila janë themeluar nga Kuvendi i FAK-ut, Bordi Ekzekutiv i cili ka pushtetin e deleguar për të ndryshuar dhe/ose krijuar rregullore.
- 1.2.4 Aktivitetet e FAK-ut përfshijnë fluturimin me ballon, fluturimin me motor, velerimin, fluturimet me helikopter, parashutizmin, aerodelimin, aerobatikën, delta planin, fluturimet microlight me paramotor, ndërtimin amator të avionëve, fluturimin manpowered, paragliding dhe të gjitha aktivitetet tjera sportive aeronautike dhe astronautike. Ato zhvillohen sipas Kodit Sportiv të FAI.
- 1.2.5 Organet/elementet zyrtare të FAK-ut janë:
- 1.2.5.1 **Kuvendi**
  - 1.2.5.2 **Bordi Ekzekutiv**
  - 1.2.5.3 **Këshilli Mbikëqyrës**
  - 1.2.5.4 **Komisionet teknike dhe profesionale të FAK**
  - 1.2.5.5 **Akademia Aviacionit Artan Venhari**
  - 1.2.5.6 **Qendra e Kontrollit Teknik dhe e çertifikimit të mjeteve fluturuese**
- 1.2.6 FAK-u financohet nga abonimi i anëtarëve dhe të hyrat që vijnë nga burimet tjera.



- 1.2.7 FAK-u është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike të Republikës së Kosovës me numrin e regjistrimit 5100411-8, me zyrën qendrore në Prishtinë. Zyra qendrore mund të zhvendoset me vendim të Kuvendit.
- 1.2.8 FAK-u vepron në përputhje me Statutet e Fédération Aéronautique Internationale (FAI), rregulloret e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), Ligjin për Sporte të Republikës së Kosovës dhe Komitetin Kombëtar Olimpik të Kosovës (KOK).

### **1.3 Qëllimet dhe Objektivat e FAK**

- 1.3.1 FAK-u si një organizatë kombëtare për promovimin e sporteve ajrore dhe fluturimit rekreativ synon të sjellë së bashku burrat dhe gratë e sporteve ajrore të Kosovës në garat kombëtare si dhe të promovojë këta sportistë në garat ndërkombëtare.
- 1.3.2 Të promovojë sportet ajrore dhe aktivitetet tjera aeronautike në Republikën e Kosovës, si dhe të promovojë Republikën e Kosovës jashtë vendit përmes aseteve të saj natyrore si një potencial i madh për të organizuar dhe pritur garat ndërkombëtare dhe ngjarjet tjera aeronautike.
- 1.3.3 Të promovojë cilësitë fizike dhe morale, njohuritë dhe aftësitë teknike si bazë për aktivitetet aeronautike dhe sportet ajrore.
- 1.3.4 Të edukojë të rinjtë përmes sportit në frymën e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe miqësisë dhe të zhvillojë aftësitë profesionale aeronautike për të rinjtë në Kosovë.
- 1.3.5 Të sigurojë qasje adekuate në hapësirën ajrore për të gjithë ata që dëshirojnë të fluturojnë.
- 1.3.6 Të ofrojë një forum për të gjithë anëtarët e saj dhe palët tjera të interesit në sportet ajrore dhe fluturime rekreative për shkëmbimin e informatave dhe diskutimin e problemeve të ndërsjella me elementet tjera të aeronautikës civile.
- 1.3.7 Të ndihmojë anëtarët e saj në organizimin e çdo lloj aktiviteti që lidhet me sportet ajrore dhe fluturimin rekreativ.

### **1.4 Funkcionet dhe Përgjegjësitë e FAK**

- 1.4.1 Të jetë autoriteti përfundimtarë për të gjitha garat kombëtare të sporteve ajrore dhe të ngjarjeve tjera të sportit ajror përfshirë garat multi-sportive.

- 1.4.2 Të zbatojë rregullat e FAI për të gjitha garat kombëtare të sporteve ajrore.
- 1.4.3 Të themelojë, përcaktojë dhe verifikoj të rekordet kombëtare të ajrit dhe hapësirës.
- 1.4.4 Të punojë me Organizatat tjera, të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e të gjithë anëtarëve të FAK-ut dhe të të gjithë sportistëve burra dhe gra në Kosovë.
- 1.4.5 Të vlerësojë aftësitë praktike të pilotëve dhe të shpërndajë bexhat e kualifikimit sipas standardeve të FAI.
- 1.4.6 Të krijojë rregullore për vlerësimin e performancave ajrore dhe hapësinore.
- 1.4.7 Të krijojë rregullore të cilat përcaktojnë kriteret e kërkuara minimale nga anëtarët e FAK-ut dhe nga të gjithë sportistët burra apo gra të Kosovës për t'u konsideruar si një anëtar aktiv/sportist, dhe për të pasur të drejtën që të marrë pjesë në gara kombëtare dhe ndërkombëtare
- 1.4.8 Të krijojë rregullore që përcaktojnë periudhën e vitit dhe kriteret për shkëmbimin e pilotëve ndërmjet anëtarëve të FAK-ut.
- 1.4.9 Të krijojë rregullore që përcaktojnë kriteret për një pilot që të jetë anëtar i Ekipit Kombëtar të Kosovës.
- 1.4.10 Të dërgojë pilotët e radhitur mirë në garat ndërkombëtare të organizuara nga FAI.
- 1.4.11 Të dërgojë pilotët e rinj dhe me prosperitet në qendrat ndërkombëtare për përgatitje dhe trajnime të veçanta.
- 1.4.12 Të shpërblejë përsosmërisë në performancë dhe kontributet e shquara në aeronautikë dhe astronautikë duke dhënë dekorata, medalje, diploma, tituj, dhe bexha, siç parashikohet në rregullore.
- 1.4.13 Të krijojë një ekip profesional të gjyqtarëve të sporteve ajrore të aftë për të përfaqësuar Kosovën në garat ndërkombëtare.
- 1.4.14 Të koordinohet me Federatat e tjera të Sporteve Ajrore në rajon me qëllim të shkëmbimit të përvojave organizative dhe të zhvillojë edhe më tutje bashkëpunimin dhe miqësinë rajonale.
- 1.4.15 Të organizojë seminare dhe punëtori me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe edukimit të Njerëzve të Sporteve Ajrore të Kosovës për aspekte të ndryshme të aeronautikës.
- 1.4.16 Të themelojë dhe monitorojë akademinë aeronautike me qëllim të trajnimit dhe edukimit profesional të të rinjve për Sportet Ajrore dhe fluturimin rekreativ.

## 1.5 Statuti i FAK-ut

- 1.5.1 Statuti, i krijuar nga Kuvendi i FAK-ut, është rregulla/at themelore e FAK-ut dhe mbizotëron mbi të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të FAK-ut.
- 1.5.2 Ndryshimet në Statut bëhen vetëm në mbledhjen e Kuvendit në të cilën janë të pranishëm të paktën gjysma e delegatëve të akredituar të të gjithë Anëtarëve Aktiv të FAK-ut me të drejtë vote dhe me kusht që amendamenti/et janë vendosur në rendin e ditës të dërguar te të gjithë Anëtarët Aktiv të FAK-ut së paku dy javë para mbledhjes së Kuvendit, me një përshkrim të hollësishëm të tekstit të propozuar. Vendimi merret me shumicën e dy të tretave (2/3) të votave të Anëtarëve Aktiv të përfaqësuar nga delegatët e akredituar të pranishëm me të drejtë vote, duke përjashtuar Anëtarët Aktiv të vitit të parë, delegatët e të cilëve nuk kanë të drejtë vote në Kuvend derisa të kalojnë 12 muaj nga miratimi i anëtarësisë së përkohshme nga Bordi Ekzekutiv i FAK-ut.
- 1.5.3 Përveç nëse përcaktohet ndryshe në kohën e vendimit, ndryshimet e Statutit do të hyjnë në fuqi nga 1 janari pas mbledhjes së Kuvendit që i ka miratuar ato.

## 1.6 Rregulloret e FAK-ut

- 1.6.1 Rregulloret e FAK-ut janë rregulla formale të shkruara, të krijuara nga Kuvendi ose nga Bordi Ekzekutiv për të udhëhequr zbatimin e Statutit. Ato merren me operimet e organizatës (FAK-ut), organizimin e garave, përkufizimin e ekipit kombëtar, rregullat për pilotët për të marrë pjesë në garat ndërkombëtare, përcaktimin e kriterëve minimale të aktivitetit për pilotin dhe/ose anëtarin e FAK-ut, përcaktimin e kodit të etikës, rekordet, bexhat, publikimet, rregullat procedurale për organet e ndryshme të FAK-ut dhe çdo çështje tjetër që është e nevojshme për kryerjen e operimeve të FAK-ut dhe aktiviteteve aeronautike ose astronautike.
- 1.6.2 Krijimi i rregulloreve dhe ndryshimeve të tyre mund të miratohet dhe zbatohet me shumicë të thjeshtë të votave të Bordit Ekzekutiv të FAK-ut.

## 1.7 Logo dhe asetet tjera të përfaqësimit

- 1.7.1 FAK-u ka logon e saj (të shënuar më poshtë), faqen e internetit, llogarinë bankare dhe adresën e përhershme.



- 1.7.2 Logoja e FAK-ut është e mbrojtur dhe mund të përdoret vetëm me lejen e Bordit Ekzekutiv të FAK-ut.
- 1.7.3 FAK-u ka vulat e saj të rrumbullakët dhe katrore, përdorimi dhe mbrojtja e vulave përcaktohet me një vendim të veçantë të Bordit Ekzekutiv.

## **1.8 Përfaqësimi i FAK-ut**

- 1.8.1 FAK-u përfaqësohet nga Kryetari. Në mungesë të Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm përfaqëson FAK-un. Në mungesë të Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, FAK-un e përfaqëson nënkryetari i FAK-ut, në rast se nënkryetarët mungojnë gjithashtu, FAK-u përfaqësohet nga anëtari i Bordit Ekzekutiv i cili përcaktohet me shumicën e thjeshtë të votave të Bordit Ekzekutiv para se të ndodhë ngjarja e përfaqësimit.

## **1.9 Marrëdhëniet dhe asocimi me organizatat tjera**

- 1.9.1 FAK-u mund të krijojë marrëdhënie me organizatat tjera pasi që ato të jenë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e saj. Me miratimin e Kuvendit ose të Bordit Ekzekutiv, mund të bashkohet me organizata të tilla, të përfaqësohet në mbledhjet e tyre ose të angazhohen në ndërmarrje të përbashkëta me to në baza të përhershme ose të përkohshme.
- 1.9.2 FAK-u është anëtare aktive e organizatave në vijim:
  - 1.9.2.1 **MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës**
  - 1.9.2.2 **KOK - Komiteti Kombëtar Olimpik i Kosovës**
  - 1.9.2.3 **AAC - Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës**
  - 1.9.2.4 **FAI - Fédération Aéronautique Internationale**

## **1.10 Parimet e menaxhimit të FAK-ut**

- 1.10.1 Kuvendi është organi më i lartë i FAK-ut, i cili përcakton objektivat e FAK-ut, miraton strategjinë afatshkurtër dhe afatgjatë të zhvillimit të FAK-ut, zgjedh Kryetarin, Bordin Ekzekutiv dhe Këshillin Mbikëqyrës. Kuvendi mund të delegojë disa nga rolet e saj tek Bordi

Ekzekutiv vetëm nëse ato miratohen nga dy të tretat (2/3) e delegatëve të akredituar të anëtarëve aktiv me të drejtë vote të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.

- 1.10.2 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut është përgjegjës për të gjitha operimet e organizatës dhe do të ushtrojë autoritet mbi organet e tjera të FAK-ut, me përjashtim të Këshillit Mbikëqyrës të FAK-ut.
- 1.10.3 Këshilli Mbikëqyrës monitoron punën e Bordit Ekzekutiv dhe paraqet raportin e tij në lidhje me punën e Bordit Ekzekutiv tek Kuvendi në mbledhjen e Kuvendit.
- 1.10.4 Komisionet e FAK-ut përgatisin dhe prezantojnë strategjitë, politikat dhe rregulloret për avancimin e sportit/disiplinës tek Bordi Ekzekutiv i FAK-ut. Bordi Ekzekutiv mund të miratojë dhe të zbatojë plotësisht/pjesërisht rekomandimet, ose të mos miratojë rekomandimin e Komisionit.

## **1.11 Shpërbërja**

- 1.11.1 Shpërndarja e FAK-ut mund të vendoset vetëm nga një Mbledhje e Jashtëzakonshme e Kuvendit e thirrur posaçërisht për këtë qëllim. Shumica e kërkuar do të jenë dy të tretat (2/3) e votave që u përkasin delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktiv me të drejtë vote. Asetet e FAK pas shpërbërjes do të transferohen tek një ose më shumë organizata jofitimprurëse të tjera sportive me qëllime të ngjashme me FAK-un. Ato do të zgjidhen nga e njëjta Mbledhje e Jashtëzakonshme e Kuvendit që ka vendosur për shpërbërjen.

## Kapitulli 2

### Anëtarësimi dhe Pjesëmarrja në FAK

---

#### 2.1 Klasat e Anëtarësisë së FAK

- 2.1.1 Anëtarësia e FAK-ut përbëhet nga organizatat kombëtare aeronautike dhe të sporteve ajrore, aero klubeve dhe shoqatave të aeronautikës të regjistruara dhe që operojnë në Republikën e Kosovës. Ekzistojnë katër klasa të anëtarësisë në FAK, bazuar në numrin e pilotëve të licencuar të cilët janë pjesë e organizatës anëtare:
- 2.1.1.1 **Anëtar i klasës A** - Organizata me së paku pesë (5) pilotë të licencuar nga AAC-ja ose FAK-u të abonuar në organizatë.
- 2.1.1.2 **Anëtar i klasës B** - Organizata me së paku dy (2) pilotë të licencuar nga AAC-ja ose FAK-u të abonuar në organizatë.
- 2.1.1.3 **Anëtar i klasës C** - Organizata me së paku një (1) pilot të licencuar nga AAC-ja ose FAK-u të abonuar në organizatë.
- 2.1.1.4 **Anëtar i klasës D** - Organizata me zero (0) pilotë të licencuar nga AAC-ja ose FAK-u të regjistruar në organizatë, por me dëshmi se kanë studentë pilotë dhe entuziast tjerë të aeronautikës të abonuar në të dhe ka aktivitete aeronautike të njohura nga FAK-u.
- 2.1.1.5 Organizata mund të vendosë të abonohet në FAK në një klasë më të ulët të anëtarësisë (ku A është klasa më e lartë dhe D është klasa më e ulët) se sa klasa për të cilën është kualifikuar në bazë të numrit të pilotëve të licencuar që janë të abonuar në të, kjo mund të bëhet për të minimizuar tarifën e anëtarësisë së organizatës drejt FAK.  
E kundërta nuk është e aplikueshme, pra, pavarësisht se çfarë tarife mund të jetë e gatshme të paguajë organizata, ajo nuk kualifikohet për klasë më të lartë nëse numri i kërkuar i pilotëve të licencuar nuk janë të abonuar në të.
- 2.1.1.6 Vlerësimet e anëtarësisë bëhen në baza vjetore, në janar të çdo viti. Përparimi i anëtarësisë së organizatës nga klasat më e ulëta në më të larta është rreptësisht e kufizuar në rritje të një klase në vit, ndërsa rënia në klasa nuk është e kufizuar!

## **2.2 Aplikimi për Anëtarësim**

- 2.2.1 Çdo organizatë që përmbushë kriteret e përcaktuara në 2.1.1 mund të dorëzoj aplikimin për anëtarësim në FAK për t'u bërë anëtarë aktiv. Aplikuesi duhet të dorëzojë në zyrën qendrore të FAK-ut një letër të aplikimit të nënshkruar në mënyrën e duhur nga Kryetari i saj, Sekretari i Përgjithshëm ose personat tjerë të autorizuar. Aplikimi duhet të shoqërohet me:
  - 2.2.1.1 Formën e aplikimit për anëtarësim, të kompletuar dhe të nënshkruar (mund të shkarkohet në faqen zyrtare të internetit të FAK-ut).
  - 2.2.1.2 Statutin e organizatës dhe rregulloret tjera.
  - 2.2.1.3 Një kopje të certifikatës së regjistrimit të organizatës.
  - 2.2.1.4 Lista e anëtarëve, zyrtarëve dhe bordi i drejtorëve duke përfshirë emrin, numrin e letërnjoftimit, datën e lindjes dhe numrin kontaktues.
  - 2.2.1.5 Konfirmimin e regjistrimit të organizatës në ndonjërin nga komunat e Republikës së Kosovës.
  - 2.2.1.6 Dëshmi që vërtetojnë që organizata merret me aktivitete aeronautike, siç mund të jenë pjesëmarrja e ndonjë anëtarë të organizatës në gara të organizuara nga Federata Aeronautike e Kosovës, ose vërtetimi se ndonjë anëtarë është në process të trajnimit në Akademinë e Aviacionit të Federatës.

## **2.3 Vlerësimi i aplikimit për Anëtarësim**

- 2.3.1 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut do të vlerësojë çdo aplikim për anëtarësim në takimin e parë të Bordit Ekzekutiv pasi që aplikacioni të jetë dorëzuar, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pasi të jetë dorëzuar aplikimi.
- 2.3.2 Bordi Ekzekutiv mund të kërkojë informata shtesë, dokumente shtesë dhe/ose intervistë me përfaqësuesin e aplikuesit.
- 2.3.3 Bordi Ekzekutiv me një shumicë të thjeshtë të votave mund të vendosë për miratimin e organizatës si Anëtar i Përkohshëm ose mund të refuzojë aplikimin.
- 2.3.4 Në rastin kur refuzohet aplikimi për anëtarësim, Bordi Ekzekutiv do të nxjerrë një dokument duke shpjeguar qartë arsyet për një vendim të tillë të Bordit Ekzekutiv.
- 2.3.5 Në rastin kur aprovohet aplikimi për anëtarësim, organizatës menjëherë i jepet statusi i Anëtarit të Përkohshëm dhe aplikimi i saj për anëtarësim përfshihet në rendin e ditës për mbledhjen e radhës/ardhshme të Kuvendit për votim për Anëtarësim Aktiv si pikë e fundit e rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit.
- 2.3.6 Kuvendi merr vendim për dhënien e statusit të Anëtarit Aktiv të aplikuesit me shumicën e dy të tretave (2/3) të votave që u përkasin delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktiv të

pranishëm në mbledhje, duke përjashtuar delegatët e Anëtarëve Aktiv që janë për vitin e parë të cilët nuk kanë e drejta e votimit në Kuvend për 12 muaj nga anëtarësimi i tyre fillestare në FAK.

- 2.3.7 Në rastin kur aplikimi për anëtarësim miratohet me vota të Kuvendit, organizatës i jepet menjëherë statusi i Anëtarit Aktiv.
- 2.3.8 Në rastin kur aplikimi për anëtarësim refuzohet me vota të Kuvendit, organizata menjëherë humbë statusin e Anëtarit të Përkohshëm dhe nuk mund të dorëzojë ndonjë aplikim për anëtarësim për periudhën prej 24 muajve nga data e vendimit të Kuvendit.

## **2.4 Mbajtja e statusit të Anëtarit Aktiv**

- 2.4.1 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut krijon një rregullore që përcakton qartë kriteret minimale të kërkuara për një anëtar që të mbajë statusin e Anëtarit Aktiv në FAK.
- 2.4.2 Vlerësimi i statusit të anëtarësimit bëhet në baza vjetore në fillim të vitit, dhe Bordi Ekzekutiv i FAK-ut publikon në faqen zyrtare të internetit të FAK-ut listën e anëtarëve të saj duke përfshirë statusin e tyre të anëtarësimit, jo më vonë se 7 prilli për vitin aktual të anëtarësimit.
- 2.4.3 Në rastin kur Bordi Ekzekutiv i FAK-ut vlerëson se ndonjë anëtar i FAK-ut nuk ka përmbushur kriteret minimale të kërkuara për mbajtjen e statusit të Anëtarit Aktiv, ai anëtar duhet të informohet për një vlerësim/vendim të tillë jo më vonë se 28/29 shkurti i atij viti. Anëtari, i cili nuk pajtohet me një vlerësim të tillë, ka të drejtë të ankohet për një vendim të tillë të Bordit Ekzekutiv dhe të japë informacione shtesë për Bordin Ekzekutiv që vërtetojnë se anëtari i përmbush kriteret minimale të përcaktuara me rregulloren e FAK-ut për të mbajtur statusin anëtarit aktiv, ankesa e tillë duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 mars.
- 2.4.4 Në rastin kur gjatë vlerësimit përfundimtar, kriteret minimale për mbajtjen e statusit të Anëtarit Aktiv nuk plotësohen nga ndonjë anëtar, statusi i anëtarit menjëherë ndryshohet në Anëtarë të Suspenduar i FAK-ut dhe vlerësimi i statusit të anëtarësimit përfshihet si pikë e fundit e rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit për mbledhjen e radhës/ardhshme ku me shumicën e dy të tretave (2/3) të votave që u përkasin delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktiv me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhje, përcaktohet statusi i anëtarësimit si Anëtar Aktiv ose Anëtar Joaktiv ose për largim të plotë të organizatës nga lista e anëtarëve të FAK-ut.
- 2.4.5 Në rastin kur statusi i një anëtar ndryshon nga Anëtar Aktiv në Anëtar Joaktiv ose largimi i plotë i anëtarësisë, Bordi Ekzekutiv do të publikojë menjëherë vendimin e tillë të ndryshimit të statusit të organizatës anëtare dhe menjëherë do të njoftojë anëtarin për këtë ndryshim. Bordi Ekzekutiv nuk mund të bëjë ndonjë rivlerësim të statusit të anëtarësimit për anëtarin joaktiv deri në periudhën e ardhshme të vlerësimit të statusit nga Mbledhja e Kuvendit.



## **2.5 Anëtar Aktiv**

- 2.5.1 Kryetari dhe sekretari i organizatës anëtare janë përgjegjës për komunikim me FAK në emër të organizatës. Si rrjedhojë, të gjitha komunikimet në të dy drejtimet (FAK -> Anëtar Aktiv, Anëtar Aktiv -> FAK) do të konsiderohen zyrtare vetëm nëse komunikohen ndërmjet zyrtarëve përgjegjës dhe nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit. Kanalet zyrtare të komunikimit janë: emailat zyrtare të Federates dhe emailat e deklaruar te Kryetarit dhe sekretarit të organizatës anëtare.
- 2.5.2 Emrat dhe të dhenat tjera kontaktuese të kryetarit dhe sekretarit të organizatës anëtare mund të ndryshohen sa here që ka ndryshime në organizatën anëtare. Kurdo që ndodh një ndryshim i tillë, FAK-u do të njoftohet menjëherë nga organizata, përndryshe FAK-u vazhdon komunikimin me personat e fundit të përcaktuar si kryetar dhe sekretar të organizatës.
- 2.5.3 Pilotët e licencuar, sportistë burra dhe gra të cilësdo degë/disiplinë aeronautike të Anëtarit Aktiv kanë të drejtën absolute për të marrë pjesë në garat kombëtare të organizuara nga FAK-u për atë degë/disiplinë, përveç nëse suspendohen nga komisioni disiplinor ose Bordi Ekzekutiv.
- 2.5.4 Pilotët e licencuar, sportistë burra dhe gra të cilësdo degë/disiplinë të aeronautikës të Anëtarit Aktiv do të marrin pjesë në garat ndërkombëtare siç përcaktohet me rregulloren e Bordit Ekzekutiv për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare, përveç nëse ata janë suspenduar nga komisioni disiplinor ose Bordi Ekzekutiv
- 2.5.5 Anëtarët aktiv do të përfaqësohen në mbledhjet e Kuvendit të FAK-ut me delegatët e tyre. Numri i delegatëve, të drejtat e votimit, natyra e votimit dhe pesha e votës për Anëtarët Aktiv janë të përcaktuara qartë në Kapitullin 3 - Kuvendi.
- 2.5.6 Anëtarët aktivë mund të organizojnë gara për çdo degë/disiplinë aeronautike dhe nëse është e përshtatshme të kërkojnë nga Bordi Ekzekutiv i FAK-ut të përfshijë garën në listën e garave Kombëtare.
- 2.5.7 Pilotët e licencuar, sportistë burra dhe gra të cilësdo degë/disiplinë aeronautike të Anëtarit Aktiv kanë të drejtën absolute të informimit të drejtëpërdrejtë dhe me kohë nga Federata, prandaj të gjithë duhet të përfshihen në listën e komunikimit informativ (FAK -> Anëtar Aktiv), ashtu që emaili [klubet@aeronautika.org](mailto:klubet@aeronautika.org) duhet të përfshijë të gjithë pilotët e licencuar të organizatës në listë.

## **2.6 Anëtar i Përkohshëm**

- 2.6.1 Anëtarët e përkohshëm gëzojnë të drejtat e njëjta sportive si çdo Anëtar Aktiv, përjashtuar të drejtën për të organizuar gara kombëtare të miratuara dhe të mbështetura nga FAK.
- 2.6.2 Anëtarët e përkohshëm mund të përfaqësohen në Mbledhjen e Kuvendit të FAK-ut me një (1) delegat si vëzhgues pa fuqi të votës.
- 2.6.3 Komunikimi ndërmjet një Anëtari të Përkohshëm dhe FAK-ut është në të njëjtin nivel sikurse FAK-u dhe Anëtari Aktiv, dhe komunikimi menaxhohet nga parimet dhe kanalet e njëjta të komunikimit.

## **2.7 Anëtar Joaktiv**

- 2.7.1 Anëtarët joaktivë nuk gëzojnë asnjë nga të drejtat sportive si çdo Anëtar Aktiv.
- 2.7.2 Anëtarët e joaktivë mund të përfaqësohen në Mbledhjen e Kuvendit të FAK-ut me një (1) delegatë si vëzhgues pa fuqi të votës.
- 2.7.3 Komunikimi ndërmjet një Anëtari Joaktiv dhe FAK-ut është i vendosur në nivelin më të ulët të komunikimit derisa statusi i anëtarit të ndryshojë.
- 2.7.4 Anëtari Joaktiv mund të kontaktojë Bordin Ekzekutiv të FAK-ut përmes kontakteve zyrtare të Bordit Ekzekutiv ashtu siç është e përcaktuar në faqen e internetit të FAK-ut.

## **2.8 Standardet detyruese për anëtarët**

- 2.8.1 Të gjithë anëtarët e FAK-ut janë të detyruar që plotësisht të respektojnë dhe t'i binden statutit të FAK-ut dhe rregulloreve tjera të FAK-ut. Është përgjegjësi e çdo anëtari që të mbajë të informuar dhe të përditësuar pilotët e vet, burra dhe gra sportiste dhe individë të tjerë me rregullat dhe rregulloret e FAK-ut.
- 2.8.2 Çdo mosrespektim dhe/ose shkelje e statutit dhe/ose rregulloreve të tjera të FAK-ut nga një pilot, sportist burrë dhe grua ose individë tjetër konsiderohet shkelje e statutit dhe/ose rregulloreve tjetër të FAK-ut nga anëtari të cilit i takon individi dhe është i abonuar tek ai.
- 2.8.3 Çdo shkelje e tillë do të adresohet nga Bordi Ekzekutiv dhe komisionet e tjera relevante të FAK-ut menjëherë pas marrjes së informatës për një shkelje të tillë të statutit dhe/ose të rregullores nga një anëtar.
- 2.8.4 Në rast të ndonjë shkeljeje, Bordi Ekzekutiv do të themelojë grupin e ekspertëve/komisionin disiplinor prej tre (3) deri në katër (4) individë duke përfshirë Kryetarin e FAK-ut, Sekretarin e Përgjithshëm, Kryesuesin e komisionit të disiplinës profesionale, nëse është e aplikueshme, dhe nëse shkelja ka filllet e saj nga një ngjarje/garë që ka ndodhur jashtë vendit, Kryesuesin e

Delegacionit/Ekipit për atë ngjarje/garë. Komisioni do të vlerësojë shkeljen e supozuar dhe do t'i ofron Bordit Ekzekutiv të gjitha faktet, rrethanat kur ka ndodhur shkelja, dhe nëse shkelja e supozuar është kryer me dashje ose me vetëdije.

- 2.8.5 Grupi i ekspertëve/komisioni brenda katër (4) javëve nga dita e pranimi të rastit, duhet të dorëzojë një raport me të gjeturat e tyre për shkeljen e supozuar tek Bordi Ekzekutiv, përfundimi i raportit mund të përfshijë ose jo rekomandime për ndonjë ndëshkim bazuar në gjetjet.
- 2.8.6 Në rastin kur raporti i grupit të ekspertëve/komisioni rekomandon që një anëtar të ndëshkohet, miratimi përfundimtar i ndëshkimit duhet të bëhet nga Bordi Ekzekutiv me shumicën e thjeshtë të votave.

## 2.9 Tarifa vjetore e anëtarësisë

- 2.9.1 Të gjithë anëtarët e FAK-ut për të mbajtur statusin e anëtarësisë aktiv janë të detyruar të kryejnë plotësisht pagesën e tarifës së anëtarësisë përmes transferit bankar në FAK, më së voni deri me 31 mars të vitit për anëtarësinë e vitit aktual. Në vijim janë dhënë tarifat e anëtarësisë sipas klasës së anëtarësisë së anëtarëve:
- 2.9.1.1 **Anëtar i klasës A** - Tarifa vjetore: 400 EUR. Nëse paguhet deri me 15 shkurt, tarifa vjetore është: 200 EUR.
- 2.9.1.2 **Anëtar i klasës B** - Tarifa vjetore: 200 EUR. Nëse paguhet deri me 15 shkurt, tarifa vjetore është: 100 EUR.
- 2.9.1.3 **Anëtar i klasës C** - Tarifa vjetore: 150 EUR. Nëse paguhet deri me 15 shkurt, tarifa vjetore është: 75 EUR.
- 2.9.1.4 **Anëtar i klasës D** - Tarifa vjetore: 100 EUR. Nëse paguhet deri me 15 shkurt, tarifa vjetore është: 50 EUR.
- 2.9.2 Në rast se ndonjë anëtar nuk arrin të kryej pagesën e anëtarësisë përmes transferit bankar brenda afatit të caktuar, ai anëtar automatikisht humb statusin e anëtarit aktiv dhe merr statusin e anëtarit joaktiv.
- 2.9.3 Të gjithë pilotët e licencuar të regjistruar në FAK dhe të abonuar si pilot tek ndonjë anëtar aktiv i FAK-ut, për të përfituar nga licencimi i FAK-ut dhe për të qenë të kualifikuar për të marrë pjesë në ngjarjet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbështetura nga FAK-u janë të detyruar që plotësisht të kryejnë pagesën e anëtarësisë së pilotit përmes transferit bankar në FAK, më së voni deri me 31 mars të vitit për anëtarësimin e vitit aktual. Tarifa vjetore e anëtarësisë së pilotit është: 40 EUR. Nëse paguhet deri me 15 shkurt, tarifa vjetore e anëtarësisë së pilotit është: 20 EUR.

2.9.4 Të gjithë pilotët e licencuar të regjistruar në FAK dhe JO të abonuar si pilot tek ndonjë anëtar aktiv i FAK-ut, për të përfituar nga licencimi i FAK-ut dhe për të qenë të kualifikuar për të marrë pjesë në ngjarjet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbështetura nga FAK-u janë të detyruar të plotësisht të kryejnë pagesën e anëtarësisë së pilotit përmes transferit bankar në FAK, më së voni deri me 31 mars të vitit për anëtarësimin e vitit aktual. Tarifa vjetore e anëtarësisë për këtë kategori të pilotit është: 300 EUR.

## Kapitulli 3

### Kuvendi

---

#### 3.1 Mbledhja e Kuvendit

- 3.1.1 Si organi më i lartë i FAK-ut, Kuvendi përbëhet nga delegatët e akredituar të emëruar nga Anëtarët Aktivë, Bordi Ekzekutiv i FAK-ut, Komisioni Mbikqyrës i FAK-ut, Kryetari i Nderit, nëse ka, dhe të ftuarit tjerë të akredituar të përcaktuar nga Bordi Ekzekutiv ose vëzhguesit siç përcaktohet me statut.
- 3.1.2 Kuvendi i FAK-ut mblidhet së paku një herë në vit në mbledhjen e rregullt.
- 3.1.3 Kuvendi mund të thirret për:
- 3.1.3.1 **Mbledhje të Rregullt të Kuvendit**
  - 3.1.3.2 **Mbledhje të Jashtëzakonshme të Kuvendit**
  - 3.1.3.3 **Mbledhje Zgjedhore të Kuvendit**
- 3.1.4 Puna e Kuvendit thirret dhe organizohet sipas rregullores "Puna e Kuvendit", rregullore e cila përcaktohet dhe miratohet nga Kuvendi, dhe një rregullore e tillë ndryshohet vetëm me dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit me të drejtë vote.
- 3.1.5 Mbledhjet e Rregullta dhe të Jashtëzakonshme të Kuvendit do të thirren dhe organizohen nga Bordi Ekzekutiv i FAK-ut.
- 3.1.6 Mbledhjet e Jashtëzakonshme të Kuvendit mund të thirren dhe të organizohen me miratimin e pesëdhjetë përqind (50% + 1 votë) të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të FAK-ut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj.
- 3.1.7 Mbledhja Zgjedhore e Kuvendit të FAK-ut do të thirret dhe organizohet nga Bordi Ekzekutiv i FAK-ut pas përfundimit të mandatit të Bordit Ekzekutiv dhe të Kryetarit.
- 3.1.8 Mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit shndërrohet në mbledhjen Zgjedhore të Kuvendit vetëm nëse dy të tretat (2/3) e delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë me të drejtë vote në Kuvend dhe të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit votojnë për një shndërrim të tillë.

## 3.2 Përbërja e Kuvendit

- 3.2.1 Delegacioni zyrtar i Anëtarëve Aktivë në mbledhjen e Kuvendit përbëhet nga numri i delegatëve të akredituar dhe të garantuar për organizatën bazuar në klasën e anëtarësimit të organizatës, siç janë:

**Anëtarësimi në klasën A** - Katër (4) delegatë me të drejtë vote, me së paku një grua delegate që është gjë e cila është detyruese për delegacionin.

**Anëtarësimi në klasën B** - Dy (2) delegatë me të drejtë vote.

**Anëtarësimi në klasën C** - Një (1) delegat me të drejtë vote.

**Anëtarësimi në klasën D** - Një (1) delegat pa ASNJË drejtë vote.

Një nga delegatët do të shërbejë si Kryesues dhe zëdhënës i Delegacionit. Anëtarët e tjerë të delegacionit do të marrin lejen e atij individ para se të mund t'i drejtohen Kuvendit.

Një delegat që përfaqëson një organizatë Anëtare Aktive në mënyrë që të akreditohet duhet të abonohet në organizatë dhe FAK-u duhet të informohet për abonimin e tillë të paktën 90 ditë para datës në të cilën mbahet Mbledhja e Kuvendit.

- 3.2.2 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut, duke përfshirë Kryetarin, Nënkryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe anëtarët tjerë të Bordit Ekzekutiv, do të përfaqësohen në mbledhjet e Kuvendit me të drejtë vote.
- 3.2.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të FAK-ut do të përfaqësohen në mbledhjen e Kuvendit PA të drejtën e votës.
- 3.2.4 Komisionet Teknike dhe Profesionale të FAK-ut përfaqësohen në Mbledhjen e Kuvendit me një (1) përfaqësues për komision PA të drejtën e votës.
- 3.2.5 Partnerët e FAK-ut dhe palët e tjera të interesit për sport dhe aeronautikë do të jenë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit si vëzhgues vetëm nëse pjesëmarrja e tillë është e shprehur qartë në rendin e ditës së Mbledhjes së Kuvendit e cila i dërgohet të gjithë Anëtarëve Aktivë në thirrjen për Mbledhje të Kuvendit.
- 3.2.6 Anëtarët e Përkohshëm të FAK-ut do të përfaqësohen me një (1) delegat në Mbledhjen e Kuvendit si vëzhgues PA të drejtën e votës.
- 3.2.7 Anëtarët Joaktiv të FAK-ut do të përfaqësohen me një (1) delegat në Mbledhjen e Kuvendit si vëzhgues PA të drejtën e votës.

### **3.3 Kuorumi dhe vlefshmëria e kuvendit**

- 3.3.1 Kuvendi konsiderohet të ketë kuorumin minimal dhe do të jetë i vlefshëm vetëm nëse gjashtëdhjetë e gjashtë për qind (66%) e delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktiv të FAK-ut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj janë të pranishëm dhe të akredituar në mbledhjen e Kuvendit.
- 3.3.2 Në rast se mbledhja e Kuvendit të thirrur dhe mbledhur nuk përmbushë kuorumin minimal të kërkuar për t'u konsideruar e vlefshme, mbledhja e Kuvendit konsiderohet e pavlefshme dhe dështuar. Thirrësi i Kuvendit ka të drejtë të thërret një mbledhje tjetër të Kuvendit e cila duhet të bëhet jo më herët se 14 ditë nga tubimi i dështuar dhe jo më vonë se 28 ditë nga tubimi i dështuar i Kuvendit. Në këtë rast, kuorumi minimal që mbledhja e Kuvendit të jetë e vlefshme, vendoset në pesëdhjetë për qind (50%) të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të FAK-ut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj dhe secili janë të pranishëm dhe të akredituar në mbledhjen e Kuvendit.
- 3.3.3 Në rast se mbledhja e Kuvendit të thirrur dhe mbledhur për herë të dytë nuk përmbushë kuorumin minimal të kërkuar për t'u konsideruar e vlefshme, mbledhja e Kuvendit konsiderohet e pavlefshme dhe dështuar. Thirrësi i Kuvendit ka të drejtë të thërret një mbledhje tjetër të Kuvendit e cila duhet të bëhet jo më herët se 28 ditë nga tubimi i dështuar dhe jo më vonë se 56 ditë nga tubimi i dështuar i Kuvendit. Në këtë rast, kuorumi minimal që mbledhja e Kuvendit të jetë e vlefshme, vendoset në dyzetë për qind (40%) të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të FAK-ut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj dhe secili janë të pranishëm dhe të akredituar në mbledhjen e Kuvendit.

### **3.4 Kompetencat e Kuvendit**

- 3.4.1 Në pajtim me Statutin dhe rregulloret, Kuvendi i FAK-ut do të merret me dhe do të vendosë për të gjitha çështjet legjislative, ekzekutive dhe financiare të FAK-ut, përfshirë:
- 3.4.2 Përcaktimin e qëllimeve, objektivave dhe politikave të FAK-ut, si dhe krijimin e mënyrës së veprimit për të arritur qëllimet e FAK-ut.
- 3.4.3 Shqyrtimin e raporteve të Kryetarit, Bordit Ekzekutiv, Këshillit Mbikëqyrës, Kryesuesve të Komisioneve Profesionale dhe Teknike dhe individëve dhe organeve të tjera sipas rastit.
- 3.4.4 Miratimin e llogarive të FAK-ut dhe të pasqyrave financiare të përgatitura nga Auditori.
- 3.4.5 Miratimin e strategjisë së zhvillimit të FAK-ut për vitin e ardhshëm.
- 3.4.6 Të vendosë për klasifikimin, abonimet dhe të drejtat e votimit të Anëtarëve.

- 3.4.7 Largimin e anëtarëve sipas dispozitave të Statutit.
- 3.4.8 Marrjen e vendimeve për ankesat kundër vendimeve të Bordit Ekzekutiv ose të Komisioneve.
- 3.4.9 Miratimin e amendamenteve të Statutit.
- 3.4.10 Caktimin e detyrave tek Bordi Ekzekutiv dhe organet e tjera sipas rastit.
- 3.4.11 Zgjedhjen e Kryetarit, Nënkryetarit, Këshillit Mbikëqyrës dhe Bordit Ekzekutiv të FAK-ut.
- 3.4.12 Pranimin e Anëtarëve të rinj dhe klasifikimin e tyre fillestar, abonimin dhe të drejtat e votimit.
- 3.4.13 Miratimin e çmimeve dhe nderimeve të propozuara.
- 3.4.14 Vendimet për të gjitha çështjet e tjera të parashtruara dhe të dorëzuara siç duhet nga Bordi Ekzekutiv, Këshilli Mbikëqyrës dhe nga Anëtarët Aktivë të FAK-ut të paktën 14 ditë para mbledhjes së Kuvendit.
- 3.4.15 Miratimin e veprimeve të Bordit Ekzekutiv dhe lirimin e përgjegjësisë për këto veprime.

### **3.5 Votimi në Kuvend**

- 3.5.1 Secili Anëtar Aktiv i FAK-ut që ka qenë anëtar i FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj nga anëtarësia fillestare në FAK dhe është përfaqësuar në Mbledhjen e Kuvendit nga delegatët e akredituar do të ketë nga zero (0) deri në katër (4) vota, varësisht nga klasa e anëtarësisë siç përcaktohet në nenin 3.2.1. të këtij dokumenti.
- 3.5.2 Vendimet e Kuvendit do të merren (miratohen) me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote, përveç nëse çështja është një problem/rast specifik i FAK-ut ose Anëtarëve të tij që përcaktohet nga ndonjë nen specifik i këtij statuti dhe e përcakton atë ndryshe ose kërkon dy të tretat (2/3) të votave të të gjithë delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote. Anëtarët Aktivë të FAK që mbajnë statusin e Anëtarësisë për më pak se dymbëdhjetë (12) muaj nga data e mbledhjes së Kuvendit në të cilën zhvillohet votimi nuk kanë të drejtë të votojnë.
- 3.5.3 Për miratimin e ndryshimit/eve të Statutit të FAK-ut, kërkohen dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote.
- 3.5.4 Votimi bëhet me votim të hapur ose të fshehtë. Votimi i hapur mund të kryhet me ngritje të dorës; përdorim të dërrasave të votimeve ose përmes thirrjes së secilit në votim. Votimi i



fshehtë bëhet me anë të fletëvotimeve me shkrim, para së cilës një komision prej jo më pak se tre (3) personave për numërimin e votave zgjidhet përmes votimit të hapur.

- 3.5.5 Kur votohet me votim të fshehtë me shkrim, secili delegatë kërkohet të vendosë në kutinë e votimit votën e tij.
- 3.5.6 Në rast të barazimit të votave (në votimin e hapur ose të fshehtë), një raund i dytë i votimit duhet të bëhet menjëherë.
- 3.5.7 Në rast të barazimit të votave për herë të dytë (në votimin e hapur ose të fshehtë), kryesuesi i Kuvendit vendos një votë shtesë për të prishur barazimin!

## Kapitulli 4

### Bordi Ekzekutiv i FAK-ut

---

#### 4.1 Përbërja e Bordit Ekzekutiv

- 4.1.1 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut do të përbëhet nga:
- 4.1.1.1 Kryetari i FAK-ut, i cili është edhe kryesues i Bordit Ekzekutiv
  - 4.1.1.2 Nënkryetari i FAK-ut
  - 4.1.1.3 Sekretari i Përgjithshëm
  - 4.1.1.4 Pesë (5) anëtarë të bordit të cilët zgjidhen nga Kuvendi
  - 4.1.1.5 Drejtori i Akademisë së Aviacionit
- 4.1.1.6 Bordi ekzekutiv i FAK-ut duhet të ketë të paktën 3 anëtarë të gjinisë të femrore në përbërje të saj.
- 4.1.2 Puna e Bordit Ekzekutiv thirret dhe organizohet sipas rregullores "Puna e Bordit Ekzekutiv", rregullore e cila përcaktohet dhe miratohet nga Kuvendi, dhe një rregullore e tillë ndryshohet vetëm me dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit me të drejtë vote.

#### 4.2 Zgjedhja e Bordit Ekzekutiv

- 4.2.1 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut zgjidhet për një mandat katërvjeçar (4) nga Kuvendi FAK-ut në të njëjtën ditë kur zgjidhet Kryetari i FAK-ut.
- 4.2.2 Menjëherë pas zgjedhjes së Kryetarit të FAK-ut, Kryetari i zgjedhur ka të drejtë t'i propozojë Kuvendit përbërjen e Bordit Ekzekutiv, duke përfshirë: Nënkryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe gjashtë (6) anëtarë të bordit, duke përcaktuar se cili nga anëtarët e bordit (duke përjashtuar Kryetarin dhe Sekretarin) do të jetë drejtor i Akademisë së Aviacionit. Në mënyrë që Bordi Ekzekutiv i propozuar të marrë mandatin, Kuvendi do të miratojë me votim me shumicë të thjeshtë propozimin si pako. Nëse miratohet me shumicë të thjeshtë votash të Kuvendit, anëtarët e Bordit Ekzekutiv marrin mandatin dhe shpallen menjëherë nga kryesuesi i mbledhjes.
- 4.2.3 Në rastin kur përbërja e propozuar e Bordit Ekzekutiv nga Kryetari i zgjedhur nuk merr miratimin e Kuvendit me shumicën e thjeshtë të votave, Kryetari i zgjedhur ka të drejtë të propozojë për herë të fundit përbërjen e Bordit Ekzekutiv. Kryetari i zgjedhur mund të propozojë të njëjtët individë ose mund të ndryshojë pjesërisht pakon e përbërjes së Bordit

Ekzekutiv. Pas propozimit të dytë, Kuvendi do të votojë me shumicë të thjeshtë për propozimin si pako.

- 4.2.4 Në rastin kur përbërja e propozuar e Bordit Ekzekutiv nga Kryetari i zgjedhur nuk merr miratimin e Kuvendit me shumicën e thjeshtë të votave për herën e dytë, anëtarët e Bordit Ekzekutiv zgjidhen sipas procedurës në vijim:
- 4.2.4.1 Katër (4) anëtarë të Bordit Ekzekutiv zgjidhen drejtpërdrejt me vota të Kuvendit. Delegatëve të akredituar me të drejtë vote në Kuvend do t'i jepet lista e votimit, e cila duhet të përmbajë emrat e të gjithë delegatëve të akredituar me të drejtë vote në Kuvend. Secili delegat me të drejtë vote do të votojë për saktësisht katër (4) persona nga lista, në rast se lista e votimit ka më shumë se katër (4) vota, fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm! Pas përfundimit të votimit, komisioni zgjedhor i Kuvendit mbledh fletët e votimit dhe publikisht numëron numrin e votave për secilin kandidat dhe shpallë rezultatet. Në rast se ka barazim të votave, rendi alfabetik me emër dhe mbiemër përdoret për të renditur listën dhe top 4 kandidatët të listës shpallen anëtarët e zgjedhur të Bordit Ekzekutiv.
- 4.2.4.2 Kandidati me numrin më të madh të votave zgjidhet drejtpërdrejtë nënkryetar i FAK-ut.
- 4.2.4.3 Kryetari i zgjedhur drejtpërsëdrejti emëron dy (2) anëtarë të bordit për Bord Ekzekutiv të FAK-ut.
- 4.2.4.4 Kryetari i zgjedhur drejtpërsëdrejti emëron drejtorin e Akademisë së Aviacionit që në mënyrë automatike është edhe anëtarë i bordit ekzekutiv të FAK.
- 4.2.4.5 Sekretari i Përgjithshëm në këtë rast do të zgjidhet drejtpërdrejtë nga Bordi Ekzekutiv me shumicën e thjeshtë të votave në mbledhjen e parë të Bordit Ekzekutiv.
- 4.2.5 Në rast se Kryetari i zgjedhur nuk pajtohet dhe nuk pranon të jetë kryesues i Bordit Ekzekutiv të zgjedhur, Kryetari i zgjedhur menjëherë do të japë dorëheqje dhe Kuvendi menjëherë njofton për mbledhjen e ardhshme zgjedhore të Kuvendit, e cila do të mbahet jo më vonë se 28 ditë nga dita e mbledhjes aktuale të Kuvendit.
- 4.2.6 Kryesuesi i Bordit Ekzekutiv për shkak të mungesës së angazhimit, mosrespektimit dhe moszbatimit të duhur të detyrave dhe obligimeve të dhëna nga Bordi Ekzekutiv tek çdo anëtar i bordit, gjatë mandatit të Bordit Ekzekutiv mund të largojë dhe zëvendësojë deri në dy (2) anëtarë të Bordit Ekzekutiv.
- 4.2.7 Në rast se kryesuesi i Bordit Ekzekutiv të FAK-ut dëshiron të zëvendësojë anëtarët shtesë të bordit pas dy (2) të zëvendësuarve, kryesuesi do të marrë miratimin me shkrim të më shumë 50% të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë me të drejtë vote në Kuvend të FAK-ut, ose mund të thërrasë një mbledhje të Kuvendit dhe të kërkojë miratimin e tillë me shumicën e thjeshtë të votave.

### **4.3 Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv**

- 4.3.1 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut do të mblidhet varësisht nga nevoja, por jo më pak se një herë në çdo tremujor.
- 4.3.2 Bordi Ekzekutiv do të thirret, organizohet dhe moderohet nga Kryetari i FAK-ut, i cili është edhe kryesues i Bordit Ekzekutiv, ndërsa me njoftimet dhe dokumentet do të merret Sekretari i Përgjithshëm.
- 4.3.3 Kryetari i fundit i kaluari i FAK-ut mund të marrë pjesë në takimet e Bordit Ekzekutiv me të drejtën për të folur por jo për të votuar.
- 4.3.4 Kuorumi i Bordit Ekzekutiv do të jetë jo më pak se katër (5) anëtarë me të drejtë vote. Në rast se vetëm pesë anëtarë me të drejtë vote janë të pranishëm, çdo vendim i Bordit Ekzekutiv duhet të jetë unanim, dhe nëse janë të pranishëm më shumë se pesë (5) anëtarë me të drejtë vote, Bordi Ekzekutiv merr vendime me shumicën e thjeshtë të votave.

### **4.4 Kompetencat dhe Detyrat e Bordit Ekzekutiv**

- 4.4.1 Bordi Ekzekutiv është organi ekzekutiv i FAK-ut, që zbaton politikat dhe vendimet e Kuvendit dhe ushtron ato kompetenca të Kuvendit që i janë deleguar atij nga ai organ.
- 4.4.2 Kuvendi ka deleguar tek Bordi Ekzekutiv kompetencën për krijimin dhe/ose amendimetimin e rregulloreve të FAK-ut, përjashtuar rregulloren për "Punën e Kuvendit", "Punën e Bordit Ekzekutiv" dhe "Punën e Këshillit Mbikëqyrës".
- 4.4.3 Bordi Ekzekutiv, i kryesuar nga kryetari i FAK-ut, është përgjegjës bashkërisht për Kuvendin për të gjitha vendimet e marra dhe veprimet e ndërmarra në mes të mbledhjeve të Kuvendit. Detyrat e tij përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
  - 4.4.3.1 Sigurimin se Statuti dhe rregulloret po vëzhgohen dhe zbatohen si duhet dhe detyrat e deleguara tek anëtarët e tij dhe/ose palët e tij po ushtrohen në mënyrë të duhur.
  - 4.4.3.2 Monitorimi dhe kontrollimi i punës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe sigurimi i limiteve buxhetore dhe udhëzimeve të politikave. Të vendosë për çdo çështje të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm dhe çdo çështje tjetër që mund të jetë e nevojshme për kryerjen e operacioneve të FAK-ut dhe aktiviteteve aeronautike.
  - 4.4.3.3 Përgjegjësia ndaj Kuvendit për të gjitha çështjet financiare dhe kontabiliteti.
  - 4.4.3.4 Paraqitja në Kuvend e llogarive për vitin e kaluar dhe për buxhetin e propozuar për vitin e ardhshëm.

- 4.4.3.5 Paraqitja në Kuvend e klasifikimit të propozuar të Anëtarëve Aktivë për vitin e ardhshëm së bashku me të drejtat e propozuara të votimit për secilën klasë.
- 4.4.3.6 Paraqitja në Kuvend e të ardhurave të parashikuara nga abonimet e anëtarëve, sporteve ajrore dhe aktivitetet e shkollës.
- 4.4.3.7 Sigurimi i zbatimit të vendimeve të Kuvendit.
- 4.4.3.8 Marrja e vendimeve ose bërja e rekomandimeve për çështje që nuk mbulohen nga Statuti.
- 4.4.3.9 Krijimi i komisioneve profesionale sportive dhe teknike, mbikëqyrja dhe monitorimi i punës së këtyre komisioneve.
- 4.4.3.10 Krijimi i grupeve ose komisioneve të tilla të punës, siç e konsideron të nevojshme për të mbështetur punën e saj, dhe shuarja e atyre që kanë përfunduar punën.
- 4.4.3.11 Miratimi i kalendarit sportiv vjetor të FAK-ut.
- 4.4.3.12 Emërimi i një ushtruesi të detyrës së Kryetarit të FAK-ut në rast të vdekjes ose paaftësisë ose dorëheqjes së Kryetarit të FAK-ut.
- 4.4.3.13 Raportimi për çështjet financiare në Kuvend.
- 4.4.3.14 Vlerësimi i aplikimeve të reja për anëtarësim dhe miratimi ose refuzimi i aplikimeve të tilla.
- 4.4.3.15 Krijimi i rregullave për përzgjedhjen e pilotëve të ekipit kombëtar, rregullores për rangimit e pilotëve, rregullores për regjistrimin e rekordeve dhe rregulloreve tjera sportive.
- 4.4.3.16 Emërimin e përfaqësuesve të FAK-ut përgjegjës për komunikim me organizatat tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 4.4.3.17 Raportimi varësisht nga nevoja tek Këshilli Mbikëqyrës i FAK-ut.

## **4.5 Votimi në Bordin Ekzekutiv**

- 4.5.1.1 Secili Anëtar i Bordit Ekzekutiv të FAK-ut ka të drejtë në një (1) votë për çdo çështje që duhet të votohet nga Bordi Ekzekutiv.
- 4.5.1.2 Përveç nëse rregullohet ndryshe nga rregullorja "Puna e Bordit Ekzekutiv", vendimet e Bordit Ekzekutiv do të merren (miratohen) me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të pranishëm në mbledhjen e Bordit Ekzekutiv.

- 4.5.1.3 Votimi në Bordin Ekzekutiv bëhet me votim të hapur. Votimi i hapur do të bëhet me ngritje të dorës.
- 4.5.1.4 Votimi në Bordin Ekzekutiv mund të jetë edhe elektronik; kushtet për një votim të tillë do të përcaktohen me rregulloren "Puna e Bordit Ekzekutiv".
- 4.5.1.5 Në rast të barazimit në votim, kryesuesi i bordit duhet të vendosë me votën e tij shtesë!

## Kapitulli 5

### Këshilli Mbikëqyrës

---

#### 5.1 Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës

- 5.1.1 Këshilli Mbikëqyrës i FAK-ut përbëhet nga tre (3) anëtarë me të drejtë vote, të cilët emërohen drejtpërdrejt nga Kuvendi.
- 5.1.2 Një nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës do të emërohet si Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës emërohet drejtpërdrejt nga vetë anëtarët e këshillit.
- 5.1.3 Rekomandohet shumë që një anëtar i zgjedhur i Këshilli Mbikëqyrës të jetë femër ose anëtar i pakicave kombëtare që jetojnë në Republikën e Kosovës.
- 5.1.4 Puna e Këshilli Mbikëqyrës thirret dhe organizohet sipas rregullore "Puna e Këshilli Mbikëqyrës", rregullore e cila përcaktohet dhe miratohet nga Kuvendi, dhe një rregullore e tillë ndryshohet vetëm me dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit me të drejtë vote.

#### 5.2 Zgjedhjet e Këshillit Mbikëqyrës

- 5.2.1 Këshilli Mbikëqyrës i FAK-ut zgjidhet për një mandat katërvjeçar (4) nga Kuvendi i FAK-ut në të njëjtën ditë kur zgjidhet kryetari i FAK-ut dhe Bordi Ekzekutiv.
- 5.2.2 Tre (3) anëtarë të Këshilli Mbikëqyrës zgjidhen drejtpërdrejt me vota të Kuvendit. Delegatëve të akredituar me të drejtë vote në Kuvend do t'i jepet lista e votimit, e cila duhet të përmbajë emrat e të gjithë delegatëve të akredituar me të drejtë vote në Kuvend, përjashtuar Kryetarin e zgjedhur të FAK-ut dhe anëtarët e zgjedhur të Bordit Ekzekutiv. Secili delegat me të drejtë vote do të votojë për saktësisht tre (3) persona nga lista, në rast se lista e votimit ka më pak ose më shumë se tre (3) vota, fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm! Pas përfundimit të votimit, komisioni zgjedhor i Kuvendit mbledh fletët e votimit dhe publikisht numëron numrin e votave për secilin kandidat dhe shpallë rezultatet. Në rast se ka barazim të votave, rendi alfabetik me emër dhe mbiemër përdoret për të renditur listën dhe top 3 kandidatëve nga lista shpallen anëtarët e zgjedhur të Këshillit Mbikëqyrës.

### **5.3 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**

- 5.3.1 Këshilli Mbikëqyrës i FAK-ut do të mblidhet varësisht nga nevoja, por jo më pas se një herë në vit.
- 5.3.2 Këshilli Mbikëqyrës do të thirret, organizohet dhe moderohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.
- 5.3.3 Kuorumi i Këshillit Mbikëqyrës do të jetë jo më pak se tre (3) anëtarë me të drejtë vote.

### **5.4 Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës**

- 5.4.1 Këshilli Mbikëqyrës monitoron punën e Bordit Ekzekutiv.
- 5.4.2 Verifikon nëse Bordi Ekzekutiv ushtron detyrat dhe kompetencat e tij sipas statutit të FAK-ut dhe rregulloreve të tjera, verifikon nëse Bordi Ekzekutiv zbaton detyrat e deleguara nga Kuvendi.
- 5.4.3 Raporton drejtpërdrejt tek Kuvendin i FAK-ut dhe paraqet gjetjet dhe rekomandimet e tij për Bordi Ekzekutiv në Kuvend.
- 5.4.4 Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit Ekzekutiv të FAK. Çdo ftesë për mbledhje të bordit të FAK i dërgohet edhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.
- 5.4.5 Këshilli Mbikëqyrës mund të intervistojë Kryetarin e FAK-ut dhe Sekretarin e Përgjithshëm.
- 5.4.6 Këshilli Mbikëqyrës mund të kërkojë që Bordi Ekzekutiv të ofrojë dokumente të ndryshme në lidhje me punën e Bordit Ekzekutiv.

### **5.5 Votimi në Këshillin Mbikëqyrës**

- 5.5.1 Secili Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të FAK-ut ka të drejtën në një (1) votë për çdo çështje që duhet të votohet.
- 5.5.2 Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës do të merren (miratohen) me shumicë të thjeshtë votash të të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të pranishëm në mbledhje.
- 5.5.3 Votimi në Këshillin Mbikëqyrës bëhet me votim të hapur. Votimi i hapur do të bëhet me ngritje të dorës.



## Kapitulli 6

### Kryetari i FAK-ut

---

#### 6.1 Zgjedhja

- 6.1.1 Kryetari i FAK-ut zgjidhet për një mandat katërvjeçar (4) nga Kuvendit nga radhët e personave të nominuar.
- 6.1.2 Kjo zgjidhje bëhet me votim të fshehtë. Në raundin e parë të votimit, kërkohet shumica absolute e votave të të gjithë delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë me të drejtë vote të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit. Nëse asnjë kandidat nuk fiton një shumicë të tillë, do të mbahet raundi i dytë i votimit dhe Kryetari zgjidhet me shumicë të thjeshtë. Nëse ka më shumë se dy persona që garojnë për Kryetar dhe nuk është marrë një shumicë e tillë në raundin e dytë, do të bëhet një raund i tretë i votimit me zgjedhje të kufizuar në dy kandidatët që morën numrin më të madh të votave në raundin e dytë; dhe Kryetari zgjidhet me shumicë të thjeshtë. Nëse raundi i dytë i votimit rezulton në barazim për numrin dy më të votuar të kandidatëve, do të ketë një raund të largimit midis kandidatëve që kanë rezultat të barabartë për të përcaktuar se kush do të garojë kundër kandidatit që ka marrë numrin më të madh të votave.
- 6.1.3 Një Kryetar i sapozgjedhur do të marrë detyrën menjëherë pas mbylljes së Mbledhjes së Kuvendit në të cilin u mbajtën këto zgjedhje.

#### 6.2 Nominimi i Kryetarit

- 6.2.1 Çdo anëtar aktiv i FAK-ut mund të nominoj një kandidat për Kryetar të FAK-ut. I nominuari për kryetar të FAK-ut duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
- Të ketë nënshtetësinë e Republikës së Kosovës;
  - Të jetë së paku tridhjetë (30) vjeçar dhe jo më i vjetër se gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçar,
  - Të jetë mbështetës i sportit/eve me rezultate të njohura në organizimin e aktiviteteve sportive,
  - Të jetë i njohur për marrëdhënie e mira me shumicën e partnerëve dhe institucioneve kryesore që kanë të bëjnë me FAK-ut, siç janë: AAC, Ministria e Sportit, FAI, KOK,
  - Të ketë reputacion dhe marrëdhënie të mira me Federatat tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

- 6.2.2 Nominimi i kandidatit për Kryetar për Mbledhjen e Kuvendit Zgjedhor i dërgohet zyrtarisht Bordit Ekzekutiv jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë nga data e caktuar për Mbledhjen e Kuvendit Zgjedhor. Nominimet e drejtpërdrejta dhe/ose ad hoc për Kryetarin e FAK-ut në Mbledhjen e Kuvendit Zgjedhor NUK lejohen me statutin e FAK-ut.
- 6.2.3 Bordi Ekzekutiv do të informojë të gjithë Anëtarët Aktivë për çdo nominim sapo të jetë dorëzuar nominimi dhe kriteret e nominimit të jenë plotësuar nga i nominuari.
- 6.2.4 Në rastin kur një mbledhje e Jashtëzakonshme të Kuvendit shndërrohet në Mbledhje Zgjedhore të Kuvendit, çdo delegat që merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit mund të nominoj drejtpërdrejt kandidatin për kryetar, në këtë rast kandidati duhet të përmbushë kriteret e nominimit të përcaktuara me statut, në këtë rast nëse ekzistojnë dokumente që kërkohet të verifikohen, kandidati i suksesshëm i cili është zgjedhur Kryetar i FAK-ut do t'i ofrojë Kuvendit dokumentet e tilla brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve. Dështimi për ta bërë këtë automatikisht rezulton me shkarkimin dhe largimin e Kryetarit dhe kufizon të drejtën e kandidatit për t'u nominuar për kryetar të FAK-ut për katër (4) vjet.
- 6.2.5 Të gjithë kandidatët e nominuar që pranojnë nominimin për Kryetar të FAK-ut janë të detyruar të prezantojnë (jo më shumë se 20 min secila) planin e tyre për organizimin dhe drejtimin e FAK-ut dhe të Bordit Ekzekutiv, përpara se të mbahen votimet për Kryetar.

### **6.3 Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit**

- 6.3.1 Kryetari do të përfaqësojë FAK-un në të gjitha rastet. Kryetari ushtron kompetencat më të gjera të lejueshme brenda kornizës së Statutit dhe rregulloreve dhe vendimeve të Kuvendit. Detyrat e Kryetarit duhet të përfshijnë:
- 6.3.1.1 Thirrja e takimeve të Bordit Ekzekutiv.
- 6.3.1.2 Nënshkrimi i kontratave dhe instrumenteve financiare, kur është e nevojshme së bashku me Anëtarët tjerë të Bordit Ekzekutiv,
- 6.3.1.3 Delegimi i detyrave tek anëtarët e Bordit Ekzekutiv dhe monitorimi i punës së deleguar tek çdo anëtar të Bordit Ekzekutiv.
- 6.3.1.4 Hartimi i strategjisë së zhvillimit të FAK-ut së bashku me anëtarët e bordit dhe prezantimi i një strategjie të tillë tek Kuvendi.
- 6.3.1.5 Të veprojnë si anëtar sipas detyrës i të gjitha Komisioneve të FAK-ut, duke marrë pjesë në çdo takim të Komisionit me të drejtën për të folur dhe rekomanduar, por pa të drejtë vote,

përveç nëse përcaktohet ndryshe për ndonjë komision të veçantë, siç mund të jetë komisioni disiplinor.

6.3.1.6 Kur shihet si e përshtatshme, të ftojë ndonjë person për të marrë pjesë në një mbledhje të Bordit Ekzekutiv të FAK-ut për një qëllim specifik zyrtar.

6.3.1.7 Raportimi në Kuvend për Bordin Ekzekutiv, me rekomandime për veprime në të ardhmen.

## **6.4 Kryetari i Nderit**

6.4.1.1 Me një shumicë prej dy të tretave (2/3) të votave të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm me të drejtë vote, Kuvendi mund të japë titullin e Kryetarit të Nderit një ish Kryetari të FAK-ut ose çdo individ tjetër që Kuvendi e vlerëson se është i vlefshëm për këtë titull.

## Kapitulli 7

### Nënkryetari

---

#### 7.1 Roli dhe përgjegjësia

- 7.1.1 Nënkryetari do të përfaqësojë FAK-un dhe do të zëvendësojë Kryetarin ose ushtruesin e detyrës së kryetarit të FAK-ut në të gjitha punët e përcaktuara me Statut, kurdo që ai/ajo mungon.

## Kapitulli 8

### Sekretari i Përgjithshëm

---

#### 8.1 Detyrat dhe Përgjegjësitë

- 8.1.1 Sekretari i Përgjithshëm do të shërbejë si Drejtor Menaxhues i FAK-ut nën autoritetin e Kryetarit të FAK-ut dhe të Bordit Ekzekutiv dhe do të jetë përgjegjës për funksionet ekzekutive dhe administrative ditore të FAK-ut.
- 8.1.2 Sekretari i Përgjithshëm i raporton Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv.
- 8.1.3 Sekretari i Përgjithshëm do të administrojë operimet dhe aktivitetet e tilla ashtu siç përcaktohen nga Bordi Ekzekutiv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për monitorimin dhe kontrollimin e të gjitha projekteve të kryera nga FAK-u dhe të sigurohet se ato janë përfunduar në kohë dhe brenda buxhetit të planifikuar.
- 8.1.4 Sekretari i Përgjithshëm do të bashkërendojë marrëdhëniet me organizatat tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 8.1.5 Çdo vit, Sekretari i Përgjithshëm do të paraqesë një raport vjetor në Kuvendin e FAK-ut me detaje të zhvillimit të Anëtarësimit, zhvillimit të sporteve ajrore dhe çdo çështje administrative që ai/ajo dëshiron të sjellë në vëmendjen e Kuvendit.
- 8.1.6 Sekretari i Përgjithshëm mund të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit.

## Kapitulli 9

### Financat e FAK-ut

---

#### 9.1 Llogaritë Financiare të FAK-ut dhe Auditimi

- 9.1.1 Viti financiar i FAK-ut është viti kalendarik.
- 9.1.2 Të ardhurat e FAK-ut do të aplikohen vetëm në mbështetje të qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në statut dhe do të rrjedhin nga dy burime kryesore:
- 9.1.2.1 Abonimet e anëtarësimit.
- 9.1.2.2 Të ardhurat ekzistuese dhe në të ardhmen nga Qeveria, aktivitetet sportive ajrore, shkolla trajnuese e FAK-ut, Donacionet, Marketingu dhe aktivitetet tjera.
- 9.1.2.3 Tarifat e shkollës dhe afatet e pagesës për këto tarifa përcaktohen nga Bordi Ekzekutiv.
- 9.1.2.4 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut do të mbajë llogaritë bankare dhe depozitat ashtu siç i sheh të jenë më të përshtatshme për kryerjen e punëve të FAK-ut. Qasje të plotë në llogaritë bankare të FAK duhet të kenë të paktën kryetari i FAK dhe Sekretari i përgjithshëm i FAK. Nëse bordi e sheh të arsyeshme, atëherë mund të emëroj edhe një (1) anëtarë tjetër të bordit ekzekutiv të FAK i cili do të ketë qasje në llogaritë bankare dhe të merret me financat e federatës.
- 9.1.2.5 Krijimi i llogarive të reja bankare për federatën, mbyllja e llogarive ekzistuese të federatës dhe autorizimi i nënshkrimit për qasje në llogaritë e federatës për anëtarët e tjerë të bordit, përveç qasjen për kryetarin dhe sekretarin e cila është e definuar me statut, e bënë bordi ekzekutiv i FAK duke nxjerre e vendim të veçantë për këto qëllime.
- 9.1.2.6 Llogaritë FAK-ut do të auditohen çdo vit nga një Auditor i Jashtëm i miratuar nga Kuvendi i FAK. Raporti i plotë i auditimit i dërgohet të gjithë anëtarëve të FAK dhe i njëjti publikohet në webfaqen e FAK.
- 9.1.2.7 FAK-u do të pranojë përgjegjësinë për të gjitha veprimet e kryera nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i FAK-ut sipas kushteve të Kushtetutës së FAK-ut dhe në mirëbesim.
- 9.1.2.8 FAK-u mund të posedojë asete të paluajtshme dhe të luajtshme.
- 9.1.2.9 Kuvendi vendos se si asetet e luajtshme dhe të paluajtshme menaxhohen dhe/ose transferohen tek një tjetër person juridik, individ dhe/ose organizatë.

## 9.2 Raportimi Financiar në FAK

- 9.2.1 Bordi ekzekutiv i FAK është i obliguar që sa herë që dorëzon ndonjë raport financiar në institucionet e Republikës së Kosovës, të njejtin raport menjëhere t’ja dërgoj të gjithë anëtarëve aktiv të sajë si dhe të njejtën ta publikoj në webfaqen e federatës. Raporti duhet të përfshijë edhe të gjitha faturat dhe fletëpagesat bankare për pagesë të këtyre faturave.
- 9.2.2 Bordi ekzekutiv i FAK është i obliguar që çdo 3 muaj të dërgoj gjendjen e detajizuar bankare për të gjitha llogaritë bankare të federatës me të gjitha transaksionet në llogari. Ky raport i dërgohet të gjithë anëtarëve aktiv të sajë.
- 9.2.3 Bordi ekzekutiv i FAK është i obliguar që çdo vit të përgatitë raportin vjetor financiar të federatës, raport i cili përfshinë të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e federatës. Shpenzimet e federatës duhet të jenë të ndara në kategori të shpenzimeve (linja buxhetore) sipas kategorive të cilat janë aprovuar nga kuvendi i FAK gjatë aprovimit të buxhetit vjetor të FAK.
- 9.2.4 Bordi ekzekutiv i FAK në rastet kur ka patur devijim në shpenzime me më shumë se 25% nga shuma e shpenzimeve për kategorinë buxhetore të aprovuar në kuvend, për cilëndo qoftë kategori buxhetore, obligohet të përgatis raport për këto devijime bashkë me arsyetimet, dhe të njejtën t’ja dërgoj të gjithë anëtarëve aktiv të sajë.

## Kapitulli 10

### Akademia Aviacionit Artan Venhari

---

#### 10.1 Dispozitat e Përgjithshme

- 10.1.1 Qëllimi i Akademisë së Aviacionit është aftësimi profesional i të gjithë studentëve të sajë duke u bazuar plotësisht dhe respektuar në përpikmëri programet e saja të licensuara në AAC.
- 10.1.2 Drejtori i Akademisë së Aviacionit Artan Venhari (shkurt: Akademia) që është edhe anëtar i bordit të FAK udhëheqë me Akademinë.
- 10.1.3 Drejtori i Akademisë propozohet nga Kryetari i FAK së bashku me propozimin për kryesinë e FAK dhe votohet nga Kuvendi i FAK.
- 10.1.4 Në rastet kur propozimi i kryetari për kryesinë e re nuk aprovohet nga kuvendi i FAK atëherë Drejtori i Akademisë emërohet drejtëpërdrejtë nga Kryetari i zgjedhur i FAK.
- 10.1.5 Drejtori i Akademisë përfaqëson Akademinë në të gjitha rastet. Drejtori ushtron kompetencat më të gjera për Akademinë e Aviacionit Artan Venhari të lejueshme brenda kornizës së statutit dhe rregulloreve dhe vendimeve të kuvendit dhe bordit ekzekutiv të FAK.
- 10.1.6 Drejtori i Akademisë shërbenë si drejtor menaxhues i Akademisë nën autoritetin e Kryetarit të FAK-ut dhe të Bordit Ekzekutiv dhe është përgjegjës për funksionet ekzekutive dhe administrative ditore të Akademisë.
- 10.1.7 Drejtori i Akademisë i raporton Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv të FAK.
- 10.1.8 Drejtori i Akademisë bashkërendon marrëdhëniet e Akademisë me organizatat tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 10.1.9 Sekretari i përgjithshëm i FAK-ut shërbenë si sekretar i Akademisë së Aviacionit Artan Venhari.

#### 10.2 Detyrat e Drejtorit



- 10.2.1 Thirrja dhe organizimi i takimeve me instruktorët e licensuar të Akademisë dhe me punonjësit tjerë administrative të akademisë.
- 10.2.2 Monitorimi i punës së instruktorëve dhe sigurimi i cilësisë së trajnimit duke u siguruar se të gjithë studentët ndjekin me përpikmëri procesin e trajnimit të përcaktuar nga programi i Akademisë.
- 10.2.3 Komunikimi me studentët dhe përgaditja e dokumentacionit administrativ për studentët e Akademisë.
- 10.2.4 Nënshkrimi i kontratave në emër të Akademisë dhe instrumenteve financiare për Akademinë, kur është e nevojshme së bashku me Anëtarët tjerë të Bordit Ekzekutiv
- 10.2.5 Delegimi i detyrave tek anëtarët e tjerë të akademisë duke përfshirë stafin administrativ dhe stafin profesional siq janë instruktorët e Akademisë dhe monitorimi i punës së deleguar tek çdo anëtar.
- 10.2.6 Hartimi i strategjisë së zhvillimit të Akademisë së Aviacionit së bashku me anëtarët e bordit ekzekutiv të FAK dhe prezantimi i një strategjie të tillë tek Kuvendi.
- 10.2.7 Raportimi në Kuvend për Akademinë e Aviacionit Artan Venhari, me rekomandime për veprime në të ardhmen.

## Kapitulli 11

### Transparenca dhe Dispozitat Përfundimtare

---

#### 11.1 Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun

- 11.1.1 E gjithë puna e Federatës është publike.
- 11.1.2 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut menjëherë do të publikojë çdo vendim të marrë nga ky organ, duke i dërguar email të gjithë Anëtarëve Aktivë dhe duke publikuar të njëjtin dokument të faqes zyrtare të FAK-ut.
- 11.1.3 FAK-u do të publikojë çdo vit raportin vjetor të miratuar nga Kuvendi.
- 11.1.4 FAK-u do të publikojë raportet e Bordit Ekzekutiv, lajmet dhe publikimet tjera në faqen e vetë zyrtare të internetit.

#### 11.2 Dispozitat Përfundimtare

- 11.2.1 Sqarimet dhe interpretimi i Statutit të FAK-ut bëhen nga Kuvendi i FAK-ut.
- 11.2.2 Në rast të amendamenteve të statutit, të gjitha rregulloret aktive dhe aktet normative të FAK-ut duhet të harmonizohen me dispozitat e statutit të amendamentuar, më së voni brenda 3 muajve nga hyrja e tyre në fuqi.
- 11.2.3 Në rast të ndonjë mospërputhjeje dhe/ose mungesës së dispozitave, mbizotëron statuti i FAI-t.
- 11.2.4 Në rastet kur Ligji i Kosovës për sportet ndryshon dhe për shkak të ndryshimit të tillë statuti i FAK-ut nuk është në harmoni me ligjin, mbizotëron Ligji i Sportit.
- 11.2.5 Ky statut është miratuar në gjuhën angleze dhe shqipe, në rast të mospërputhjeve mbizotëron versioni në gjuhën angleze.